



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2019:242251

Datë: 08.05.2024

Numri i dokumentit: 05734610

KE.nr.154/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e shkallës së parë – Departamenti për çështje Ekonomike, gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen juridike kontestimore të paditësit NNSH Kapitali” SHPK. me numër të biznesit 810896847 me seli në Prishtinë dhe Kapital “X” SHPK. të cilët i përfaqëson sipas autorizimit Av. Artan Bunjaku, me seli të zyrës në Prishtinë, kundër të paditurës Komuna e Graçanicës të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Av. Negovan Sharanoviq, me seli të zyrës në Graçanicës, për shkak të padisë për kompensimin e dëmit, pas mbajtjes se seancës se datës 08.04.2024, për shqyrtim kryesor te çështjes, ne datën 08.05.2024, jashtë seancës mori këtë:

A K T G J Y K I M

1. APROVOHET NË TËRËSI SI E BAZUAR kërkesëpadia e paditëseve: NNSH “Kapitali ” me numër të biznesit 810822719 dhe Kapital “X” SHPK me NUI 810896847 që të dyja me seli në Prishtinë.
2. DETYROHET e paditura Komuna e Graçanicës që t’i paguaj paditëseve shumën prej 8,700.00 Euro (tetë mijë e shtatëqind euro) në emër të kompensimit të dëmit, me kamatë ligjore prej 8%, duke e llogaritur nga data 20.12.2016 deri në pagesën definitive të borxhit, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi e nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

3. OBLIGOHET e paditura Komuna e Graçanicës që paditësit t'ia paguajë shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 1.670.00 Euro në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

I. Historiku i çështjes / pretendimet e palëve ndërgjyqëse

Paditësit mbi bazën e fitimit të tenderit me të paditurën kanë lidhur kontratë me numër identifikues GRA-618/16/035/521 datë 16.08.2016, me qëllim të renovimit të shkollave, ndërtimit të objekteve, parterit dhe rrethojave në Komunën e Graçanicës. Pas realizimit të punëve ndërtimore të përshkuara si në pikën I të kësaj padie, paditësi në përputhje me nenin 22 të kontratës ka bërë të gjitha përgatitje për fillimin e punimeve, ka paguar policen për sigurimin e kontratës, ka gjetur pajisjet dhe materialet të nevojshme për fillimin e punimeve dhe ka arritur marrëveshje me nënkontraktoret.

Me tej paditësi në padinë e tij ka shtuar se i njëjti ka kërkuar në vazhdimësi që të dorëzohet në posedim objekti ku do të kryheshin punimet ndërtimore në shkollën e fshatit Gushtericë, me të vetmin qëllim që të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme për sigurinë e objektit brenda dhe jashtë, por e paditura asnjëherë nuk ka qenë bashkëpunuese me paditësin duke e prolonguar fillimin e punimeve dhe duke bërë kërkesa absurde në kundërshtim me nenin 6.8 të kontratës për sigurimin e vend punishtës. E paditura kishte kërkuar që të fillojnë punimet pa i larguar nxënësit nga klasat ose nxënësit të zhvilloj mësimin paradite ndërsa paditësi të kryente punimet mbas dite. Paditësi në referatin e padisë kishte deklaruar se e paditura kishte bërë të pa mundur ekzekutimin e kontratës për fillimin e punimeve ndërtimore dhe nuk kishte ofruar ndonjë planë të arsyeshme dhe të vlefshëm sipas standardit të miratuar nga KRPP-ja për menaxhimin e kontratës, kështu që e paditura me këto veprime kishte shkelur neni 10.1 të paraparë në pjesën e Kushteve të veçanta të Kontratës.

I autorizuari i paditësit në seancat gjyqësore dhe në fjalën përfundimtare kishte deklaruar se mbesim pranë padisë së datës 20.12.2016, e gjithashtu mbesim pranë pretendimeve pranë të gjitha të paraqitura në seancën paraprake të datës 20.06.2023. Meqenëse është pronari i kompanive

këtu i për çka është aprovuar kërkesa të dëgjohet në cilësinë e palës, propozoj që të dëgjohet i njëjti.

Po asht pala në seancat gjyqësore kishte shtuar se unë ushtroj biznesin e ndërtimtarisë që 15 vite e më shumë, në vitin 2016 është kontraktuar kontrata me Komunën e Garancisë dhe në disa emali të mija dhe takime që kemi pas kam tentuar që ta kryej kontratën duke dhënë propozime të ndryshme, por zyra e prokurimit së Komunës së Graçanicës bashkë më zyrtaren e urbanizmin Znj. M.L., nuk i kanë përfillur kërkesat e mija për implementim duke më detyruar që të hy në punime ndërtimore me nxënës në klasë, në shkollë dhe duke rrezikuar kualitetin e punëve si dhe sigurinë e punëtorëve të mi dhe nxënësve, gjë që kam konsideruar se zyrtarët e prokurimit së bashku me zyrtaren e urbanizmit, nuk më kanë krijuar kushtet për punë që kanë qenë të obliguar t'i sigurojë kushtet e kontratës. Prandaj duke mos siguruar kushtet për fillimin e punimeve jam detyruar që të padisë komunën për mos përmbushje të kushteve të kontratës si dhe mos zbatim të Ligjit të Ndërtimit, që do të thotë nuk janë përmbushë kushtet e ligjit të ndërtimi, ligjit për mbrojtje në punë. Pra pala paditëse kishte theksuar se është pamundësuar puna për shkak të nxënësve e që po të punohej do të ishte vepër penale (rrezikim i përgjithshëm), andaj komuna është dashur të më sigurojë punishten në mënyrë që unë të përmbushë kontratën.

Tutje i autorizuari i paditësit në fjalën përfundimtare ka theksuar se konsiderojmë se është provuar dhe argumentuar mjaftueshëm fakti se e paditura me faj të saj ka shkëputur njëanshëm kontratën, meqenëse ka dështuar të plotësoj kushtet për punë të paditësve sepse e paditura në përgjigje në padi, e as ekspertit gjyqësor, dhe as gjatë shqyrtimit gjyqësor, nuk ka dorëzuar asnjë provë lidhur me plotësimin e detyrimit të saj për dorëzim të vend punishtes të paditësit, çka do të thotë se e paditura nuk ka nxjerrë asnjë Vendim për shtyrjen apo zhvendosjen e përkohshme të procesit mësimor në ndonjë objekt tjetër, deri në përfundimin e punëve ndërtimore.

Ky fakt vërtetohet edhe në bazë të deklaratave të dëshmitarëve: M.L. e cila ishte menaxhere e kontratës e caktuar nga e paditura, dhe A.R. i cili ishte menaxher i prokurimit të e paditura, dhe asnjëri prej tyre nuk dhanë asnjë provë se e paditura u ka krijuar kushte për punë paditësve. Përkundrazi, që të dy dëshmitarët M.L. (dhe A.R., ishin tepër konfuz dhe jo koherent në dëshmitë e tyre, ngase që të dy pretendonin se afati për kryerjen e punëve ndërtimore ishte 31 ditë, dhe kjo ishte në kundërshtim të plotë me afatin 3 muaj të përcaktuar në KVK - kushtet e veçanta kontraktuese, që të dy ishin në kundërshtim me afatet kontraktuese pretendonin se punët ndërtimore do të mund të ekzekutoheshin gjatë pushimit veror, apo të ekzekutoheshin pa

e ndërprerë procesin mësimor (me nxënës në shkollë), dhe kjo ishte në kundërshtim të plotë me Kontratën GRA-618//6/035/521 e lidhur me datë 16.08.2016, si dhe me detyrat e kontraktuesit për të ofruar sigurinë sipas të gjitha ligjeve të aplikueshme.

Po ashtu duhet i autorizuari i paditëseve ka deklaruar se Drejtori i shkollës, në takim gjatë inspektimit të shkollës, në prani të përfaqësuesit të të paditurës (menaxherit të kontratës), taksativisht i ka thënë paditësit se nuk mund të ndërpritet procesi mësimor për arsye se këtë nuk po e lejon Ministria e Arsimit e R. Serbisë. Pretendimin e drejtorit të shkollës për marrjen e lejes nga Ministria e Arsimit e Serbisë e konstaton edhe ekspertiza, sepse ekspertit në mënyrë abuzive i janë ofruar dokumente të dyshimta në datë dhe protokoll që nuk kanë të bëjnë fare me periudhën kontraktuese.

Prandaj i njëjti ka theksuar se natyra e urdhrave të kundërligjshëm për fillimin e punëve, vërtetohet me faktin se e paditura pa i krijuar kushtet për punë, gjegjësisht pa e dorëzuar Shkollën në Gushtericë të lirë nga nxënësit dhe personeli mësimor, ka urdhëruar paditësit t'i ekzekutojnë punët ndërtimore. Sikur paditësit të vepronin në bazë të urdhrave të tillë të të paditurës, dhe të fillonin ekzekutimin e punëve ndërtimore kur në vend punishte pandërprerë do kishte lëvizje të nxënësve dhe personelit mësimor, paditësit në asnjë rrethanë nuk do të mund të siguronin vend punishtet nga brenda, as perimetrin e saj nga jashtë, as kualitetin e punëve ndërtimore. Përkundrazi, kryerja e punëve ndërtimore në kushte të tilla do të ishte në kundërshtim me Ligjin e punës, me Ligjin për mbrojtjen dhe sigurinë në punë, me Ligjin për mbrojtjen e shëndetit publik, me Ligjin e ndërtimit, dhe sikur paditësit në këto rrethana të ekzekutonin punët ndërtimore do të konsumonin vepër penale të parashikuar me nenit 360 të KPK, për punime ndërtimore të kundërligjshme, për të cilat do të mund të dënoheshim nga 6 muaj deri në 5 vite burgim, nëse punët e tilla do të rezultonin me lëndim të rëndë trupor dënimi do të ishte nga 1 - 8 vite burg, po në rast se do të pasonim me vdekjen e ndokujt në vend punishte atëherë dënimi do të ishte nga 3 deri në 12 vite burgim.

Prandaj duke u bazuar në të gjitha analizat e fakteve, dhe argumenteve të parashtruara si më sipër, paditësit Gjykatës Komerciale — Dhomës së Shkallës së Parë, i kanë propozuar që të nxjerrë aktgjykim me të cilin do të aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditëseve: Kapital-x sh.p.k. NUI 810822719, dhe NNSH. Kapital, me NUI 810896847, - që të dyja nga Prishtina, me të cilën paditësit kanë kërkuar kompensimit e dëmit të shkaktuar nga e paditura për shkak të shkëputjes së njëanshme të Kontratës GRA-618/16/035/521, "Renovimi i shkollave, ndërtimit i

objekteve, paterit dhe rrethojave në Komunën e Graçanicës — Lot I — Renovimi i Shkollës në Gushtericë.

Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar dhe i ka specifikuar.

E Paditura, në tërësi qëndron ndaj deklarimeve të bëra gjatë seancës të shqyrtimit gjyqësor si me shkrim të përgjigjes në padi dhe deklaratës me shkrim në seancën paraprake të të shqyrtimit gjyqësor të datës 06.03.2023, si dhe verbalisht në procesverbalin e seancës paraprake dhe seancës gjyqësore, si dhe në provat e propozuara dhe të nxjerra.

Pala e paditur konstaton se pas dëgjimit të dëshmitarëve të propozuar si dhe në bazë të rezultateve të procedurës në tërësi, padia është kundërshtuar në mënyrë të besueshme dhe të mjaftueshme.

Gjatë procesit gjyqësor dëshmitarët L.M. dhe A.R. konfirmuan se nuk ka pasur lëshime procedurale nga ana e të Paditurës Komunës të Graçanicës gjatë anulimit të njëanshëm të kontratës, nuk ka pasur asnjë veprim të kundërligjshëm nga i Padituri, dhe se vërejtja e avokatit të Paditësit që e Paditura ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e kontratës me nr. të protokollit GRA-618/16/035/521 të depozituar në arkivën e Komunës të Graçanicës me numër të biznesit 5400/16, të datës 16.08.2016.

I autorizuri i të paditures ka theksuar se pretendimet e pabaza janë bërë në deklaratën e avokatit të Paditësit dhe personit përgjegjës për Paditësin, ku shprehen se janë penguar në kryerjen e punëve të kontraktuara për shkak të sigurisë të nxënësve në shkollë. Ajo që është e pakontestueshme, e cila rezulton nga shqyrtimi gjyqësor i mbajtur, është se Paditësit nuk kanë vepruar sipas disa urdhrave për punime të të Paditurit, gjë që e ka shtyer të Paditurin, në pajtim me ligjin dhe dispozitat e kontratës, në ndërprerjen e njëanshme të kontratës me Paditësit.

Kështu që, rreziku i supozuar për shëndetin e nxënësve të shkollës në fshatin Gushtericë dhe refuzimi i Drejtorit të shkollës për ta ndërprerë mësimin është vetëm një arsyetim jo i mirë nga Paditësit. Palët paditëse kanë pasur obligim kontraktor që t'i fillonin punimet në gjysmën e dytë të pushimeve verore shkollore të vitit 2016, që të ishte kohë e mjaftueshme për fillimin dhe zbatimin e pjesës më të madhe të obligimit kontraktor.

Megjithatë, Paditësit e zëvendësojnë tezën me qëllim që ta shpiejnë Gjykatën drejt përfundimit të gabuar se Paditësit janë penguar në përmbushjen e obligimeve kontraktuale, kur merret parasysh se shkaku gjyqësor i shkëputjes të njëanshme të kontratës është refuzimi i Paditësit për të vepruar sipas urdhrave për punime të dhëna nga të Paditurit. Lidhur me këtë, Paditësit madje theksojnë se kanë propozuar që puna në shkollë të shtyhet për pushime dimërore, gjë që është e pabazë kur merret parasysh se pushimet dimërore zgjasin rreth dy javë (14 ditë), po aq sa Paditësit kanë pasur ditë të lira (nga 16. 08. 2016 deri më 01.09. 2016) gjatë pushimeve verore të shkollës për të filluar dhe kryer punë në shkollën në Gushtericë (të cekur në procesverbalin e seancës përgatitore më 21. 3. 2024).

Para anulimit të njëanshëm të kontratës në fjalë, Pala e paditur ka shprehur këmbënguljen e saj për të detyruar Paditësin që brenda afatit kohor t'i fillojë punimet e kontraktuara dhe t'i përfundojë periudhës kohore më të shkurtër të mundshme.

Pasi i shteroi të gjitha përpjekjet dashamirëse dhe kur u pa qartë se Paditësi nuk donte të vepronte sipas urdhrave për punime të të Paditurës, Zyra e Prokurimit Publik më 09.11. 2016 ka marr vendim të njëanshëm për ndërprerjen e kontratës të emërtuar: “Renovimi i shkollave, ndërtimi i objektit, katit përdhese dhe rrethojave në Komunën e Graçanicës – (Loti 1 – Renovimi i shkollës në Gushtericë)” me numër të identifikimit GRA-618/16/035/521, dhe në përputhje me këtë të Paditurve iu dorëzon: Raportin 1-2016 GRA 618/16/035/521 e datës 25.08.2016, Raportin 2-2016, Raportin 3-2016, Raportin 4-2016 dhe Raportin 5-2016.

Ndërprerja e kontratës është e bazuar në Nenin 26 të Kontratës të lidhur më 16/08/2016 ndërmjet Autoritetit Kontraktues të Komunës të Graçanicës dhe Konsorciumit Sh.P.K “KAPITAL-X” Prishtinë, me numër të biznesit 70657319 për projektin “Renovimi i shkollave, ndërtimi i objektit, katit përdhese dhe rrethojave në Komunën e Graçanicës-(Loti 1 – Renovimi i shkollës në Gushtericë)” me numër të identifikimit GRA-618/16/035/521, gjë që Pala paditëse e ka mbështetur me dorëzimin e shkresave të lëndës: Kërkesa GRA 618/16/035/521.

Gjithashtu, për të mbështetur synimin për t'i obliguar Paditësit që të fillojnë punimet, Paditësive u janë dërguar me e-mail nga Menaxherja e kësaj kontrate L.M.: Urdhri për punime i datës 05/10/2016, Urdhri për punime i datës 10/10/2016 dhe Urdhri për punime i datës 12/10/2016.

Gjithashtu, një numër i madh i takimeve të përbashkëta është mbajtur nga autoriteti mbikëqyrës dhe Zyrës të Prokurimit Publik, si dhe janë bërë shumë telefonata për fillimin e punës, siç dëshmohet nga korrespondenca me e-mail e dorëzuar në shkresat e lëndës nga i Padituri.

Së fundi, me datë 20.10.2016, Paditësit kanë pranuar një paralajmërim përfundimtar nga Zyra e Prokurimit Publik për të filluar punimet në afat prej 5 (pesë) ditësh sipas kërkesës – Urdhrit për punime nga menaxheri i kësaj kontrate, mirëpo konsorciumi nuk ka vepruar sipas vërejtjes dhe nuk i ka filluar punimet.

Në bazë të të gjithave të paraqitura, Paditësit nuk i kanë respektuar Nenet e Marrëveshjes me nr. të protokollit GRA-618/16/035/521 të deponuar në arkivën e Komunës të Graçanicës me numrin të biznesit 5400/16, të datës 16.8. 2016, përkatësisht: Neni 6 — Detyrimet e kontraktorit dhe Neni 10 — Fillimi i punimeve, dhe në bazë të faktit se me datë 09 dhe 17 të vitit 2016 Zyra e Prokurimit Publik ka marr vendim për ndërprejen e njëanshme të kontratës.

Prandaj në bazë të asaj që është paraqitur dhe dokumentuar, Pala e Paditur Komuna e Graçanicës i ka propozuar kësaj Gjykate që kërkesë-padia e Paditësve të refuzohet si e pabazë.

Shpenzimet e procedurës kontestimore i kërkojmë në përputhje me tarifën e Odës të Avokatëve të Kosovës, të cilat i paraqesim në shkresat e lëndës së bashku me deklaratën me shkrim.

II. Administrimi i provave

Deklarimet e të autorizuarit të paditësit, deklaramet e përfaqësuesit të autorizuar të të paditurës si dhe provat tjera të prezantuara dhe të administruara, gjykata i vlerësoi të gjitha, një nga një dhe në varësi me njëra tjetrën, në vështrim të nenit 8, të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK). Në kontestin e përgjithshëm të procedurës provuese lidhur me faktet vendimtare për përcaktimin e rrethanave të kësaj çështje kontestuese, gjykata i është referuar provave të administruara si në vijim:

1. Kontrata me numër të protokollit 5/400/16, e dt.16.08.2016;
2. Raporti 1-2016;
3. Raporti 2-2016;
4. Raporti 3-2016;

5. Raporti 4-2016;
6. Raporti 5-2016;
7. Njoftimi për shkëputjen e kontratës me numër protokollit 7391-2016-ë, i dt.09.11.2016;
8. Email-i i Komunës së Graçanicës, i dt.20.10.2016;
9. Kërkesa drejtuar Komunës së Graçanicës, nga V.X., me numër 2016-08-31;
10. Deklarata me numër protokollit 648-2017, e dt.02.02.2017;
11. Raporti i vendit të ndërtimit, me numër 6047/16, i dt.14.09.2016;
12. Kërkesa për rinovimin e shkollës, në Gushtericë, e dt.07.10.2016-ë;
13. Email-at e datave 23.08.2016, 24.08.2016, 25.08.2016, 26.08.2016, 23.09.2016, 28.09.2016, 30.09.2016, 02.10.2016, 03.10.2016, 04.10.2016 05.10.2016, 06.10.2016, 10.10.2016, 12.10.2016, 13.10.2016, 25.10.2016 dhe 23.11.2016;
14. Raporti i vlerësimit i dt.09.01.2019;

-Nga Kontrata me numër të protokollit 5400/16, e dt.16.08.2016 e lidhur ne mes palëve ndërgjyqëse gjykata konstatoi se kjo Kontrata ka pasur për objekt Renovimi i shkollave, ndërtimi i objekteve, parterit dhe rrethojave në Komunën e Graçanicës, afati i përmbushjes së kësaj kontrate ishte në një periudhe 3 mujore (13.08.2016) si dhe çmimi i të njëjtës ishte në lartësi prej 28,332.21euro.

Çështja kontestuese në këtë kontrata ishte mos zbatimi i nenit 6 paragrafi 6.6 deri në paragrafin 6.9 të këtij neni e sidomos neni 6.8 me të cilin parashihet se që: “ kontraktuesi duhet të siguroj zonën e ndërtimit menjëherë pas fillimit të punës për arsye në raste se për punimet e kryera përdorën pajisje të renda si: Ekskavator, vinça, skele, kamion, të llojeve të ndryshme dhe si me kushtin e dytë parashihet se me përdorimit e pajisjeve të lartcekura mund të dëmtohen kalimtarët e rastit, objektet për rreth trafiku etj. Po ashtu gjykata vlerësoj se në neni 17 të kontratës me të cilin ishin përcaktuar Shkaqet e kompensimit ku nder të tjera në po të njëjtin nen (17.1 pika a) thuhet citoj: Autoriteti kontraktues nuk lejon qasjen në një pjesë të vend ndërtimit data e specifikuar në KVK dhe pika g) *Kontraktuesi has në pengesa për kryerjen e punëve të kontraktura të cilat pengesa nuk janë për shkak të jo profesionalizmit të kontraktuesit.* Gjithashtu, kjo gjykatë nga Kontrata në fjalë, vërejti se me paragrafët e lartpërmendur në mënyrë shprehimore ishin caktuar kushte se në ngjarjet e tilla çmimi i kontratës do të rregullohet sipas paragrafi 3 i po këtij neni i cili parasheh citoj: “*Autoriteti Kontraktues, pas lëshimit të njoftimit të ndërprerjes së kontratës, do ta udhëzojë Furnizuesin që të ndërmarrë hapa të menjëhershëm për ta përmbyllur ekzekutimin e furnizimeve në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt dhe për t’i zvogëluar në minimum shpenzimet*”.

Nga Raportit 1-2016,Raporti 2-2016, Raporti 3-2016, Raporti 4-2016 dhe Raporti 5-2016, gjykata ka konstatuar se paditësi përmes këtyre raporteve i ka sqaruar Autoriteti Kontraktues se pozicionet që nuk mund të realizohen sipas kushteve të kontratës janë: Punët e nivelizimit, punët në dyshemenë (pozicioni 3dhe 4), nder të tjera në këto raporte sqarohet takimet që janë zhvilluar në mes të Operatorit Ekonomik (Konzorciumit dhe Autoritetit kontraktues dhe Drejtorit të shkollës, në të cilat raporte vërehet qartë se Operatori Ekonomik kishte insistuar për të gjetur një zgjidhje për realizimin e Kontratës, por nuk kishte hasur në mirëkuptim nga Menaxheri i Kontratës, Drejtori i Shkollës dhe zyrtar të tjerë të Prokurimit.

Gjykata vlerësoj komunikimet tjera me emali ku Menaxheri i prokurimit kishte tërhequr vrenjten Operatorit Ekonomik që nëse nuk filloj punimet në harmoni me Kushtet e Veçanta të Kantatës deri me datën 25/10/2016, do të ju shkëputet kontrata në harmoni me LPP-në. Po në të njëjtin email Operatori Ekonomik ka kërkuar nga Menaxheri i Kontratës duke i sqaruar se nuk mundet të filloj punimet me nxënës në klasë, materialet për rregullimin e dyshemesë nuk mund të përdoret me inventar në klasë.

-Nga Njoftimi për shkëputjen e kontratës me numër protokollit 7391-2016-ë, i dt.09.11.2016, gjykata ka konstatuar se Autoriteti Kontraktues e ka shkëputur kontratën pas disa takime dhe shkëmbimit të emaileve me Operatoret Ekonomik (Konzorciumin). Po ashtu Menaxheri i kontratës në arsyetimin e dhënë ka theksuar se pas vërejtjeve të marra dhe afatit 5 ditor operatori ekonomik nuk ka filluar punimet, prandaj duke u bazuar në kushtet e kontratës nuk është zbatuar neni 6 (Obligimet Kontraktuese) dhe neni 10 (Fillimi i Punimeve).

-Nga Kërkesa drejtuar Komunës së Graçanicës, nga V.X., me numër 2016-08-31, gjykata ka konstatuar se Operatori ekonomik ka kërkuar nga Autoriteti Kontraktues punë shtesë për realizimin e kontratës ngase ishte kërkuar nga Autoriteti Kontraktues riparimi i dyshemesë. Prandaj realizimi i këtyre pozicioneve mund të realizohet pa ndërprerë procesin mësimor dhe në një afat sa më të shkurtër kohor.

Nga Deklarata me numër protokollit 648-2017, e dt.02.02.2017, gjykata konstaton se menaxheri i projektit ka sjelluar një raport teknik ku në mes tjerash kishte thënë se nuk mund të realizohet projekti duke përdoruar materialin estrih, por duhet të analizohet mundësia e përdorimit të ndonjë materiali tjetër që të vendoset mbi parketin ekzistues. Në këtë njoftim theksohet se në takomini me Drejtorin e Shkollës Miloradom Filipovic i njëjti kishte deklaruar se nxënësit duhet të kthehen në Shkollën me date 01.09.2016, por për ditët e mbetura duhet të kemi miratimin e

Ministrisë së Republikës së Serbisë. Tutje në këtë njoftim kishte shtuar se të gjitha punët mund të realizohen pa ndërprerjen e mësimit.

-Nga Raporti i vendit të ndërtimit, me numër 6047/16, i dt.14.09.2016, gjykata konstatoj se kontraktuesi ka paraqitur një faturë për sasinë dhe vlerësimin e punëve si dhe vlerën e projektit i cili ka paraqitur një planë dinamik dhe të njëjtit është lejuar realizimi i projektit, mirëpo punëkryesi nuk e ka realizuar punët për rregullimin e dyshemesë dhe ndërrimin e derës dhe këtë nuk e ka filluar deri në zgjidhjen e problemit.

-Nga Kërkesa për rinovimin e shkollës, në Gushtericë, e dt.07.10.2016-ë, gjykata ka konstatuar se kontraktori-Operatori ekonomik ishte i detyruar të filloj punimet në mënyrë që të vazhdohet pa probleme. Pas takimeve të shumta dhe telefonatave, Operatorin Ekonomik nuk ka nisur punimet pasi ai pretendon se nuk ka kushte për punë.

-Nga Emali-at e datave 23.08.2016, 24.08.2016, 25.08.2016, 26.08.2016, 23.09.2016, 28.09.2016, 30.09.2016, 02.10.2016, 03.10.2016, 04.10.2016 05.10.2016, 06.10.2016, 10.10.2016, 12.10.2016, 13.10.2016, 25.10.2016 dhe 23.11.2016, gjykata ka konstatuar se palët ndërgjyqës kanë tentuar të gjejnë një zgjidhje për fillimin e punimeve, ku nder të e paditura kishte propozuar që në marrëveshje me shefin e Prokurimit, Drejtorin e shkollës dhe drejtorin e Urbanizmit, punimet të fillojnë në katin përdhes, e pastaj drejtori i shkollës do t'i zhvendos nxënësit nëpër klasa të tjera,

-Nga Raporti i vlerësimit i dt.09.01.2019, gjykata vërtetoi se eksperti Lulëzim Dema kishte dhënë Konstatimin ku kishte vlerësuar se kompensimi i dëmit të bëhet vetëm për pjesën e fuqisë punëtore e cila përfshin parapërgatitjen dhe demolimin, pa i përlllogaritur pozicionet e zdrukthëtarisë dhe nivelimit të cilat pozicione do të bëheshin nga sub kontraktorit. Gjykata vërteton se eksperti në faqen 13 dhe 14 në mënyrë të detajuar kishte elaboruar dhe kishte dhënë një vlerësim të saktë duke përlllogaritur dëmin në lartësinë prej 8,700.00 euro, shumë e cila duhet të kompensohet paditësi për punët e kryera deri në ndërprerjen e kontratës.

III. Vendimi i gjykatës

Pas vlerësimit dhe shqyrtimit të hollësishëm të secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, duke bërë vlerësimin e tyre në vështrim të dispozitës së nenit 8.1 dhe 8.2 të LPK-së, Gjykata vërtetoi se kërkesëpadia e paditësit është në tërësi e bazuar.

Nga provat e administruara, Gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike: në mes të palëve ndërgjyqëse nga provat e administruara rezulton se nuk është kontestuese fakti se paditësit NNSH “Kapitali” me numër të biznesit 810822719 dhe Kapital “X” SHPK me NUI 810896847 (Konzorciumi) me të paditurën Komuna e Graçanicës kanë qenë në marrëdhënie kontraktuale përmes Kontrata me numër të protokollit 5400/16, e dt.16.08.2016-Kontrat për Renovimin e Shkollës në fshatin Gushtericë. Kjo Kontrata është lidhur nga palët me datë 16.08.2016, dhe ka qenë në vlerë 28,332.21euro, po ashtu në këtë kontratë ishin paraparë kushtet e përgjithshme dhe të veçanta me të cilat ishin kontraktuar të gjitha detyrimet dhe përmbushja e tyre rreth këtij kontraktimi.

Gjykata ka konstatuar që në bazë të kësaj kontratë, përkatësisht nga Kushtet e përgjithshme të kontratës në nenin 6 ishte paraparë obligimet kontraktuale ku e paditura është e obliguar që të siguroj Operatorin Ekonomik teren të përshtatshme për zbatimin e punimeve pa shkaktuar dëme në njerëz, objekteve për rreth dhe trafik. Kjo gjykatë gjithashtu ka konstatuar nga e-mail-at e shkëmbyera ndërmjet palëve ndërgjyqëse, provat tjera të administruara më lart, se paditësit kanë qenë në gatishmëri të realizoj projektin sipas kushte të kontratës, mirëpo nuk kanë gjetur mirëkuptim nga ana e Autoritetit Kontraktues, gjë nga provat konkrete vrehte se paditësit për kundër insistimit nuk kanë mundur të realizoj këtë projekt të paraparë me kontrate. Gjykata vërteton se propozimet e ofruara nga Autoriteti Kontraktues për realizimin e kontratës ishin propozime në kundërshtim me kushte e përgjithshme të kontratës, prandaj Operatorit Ekonomik nuk ka mundur të veproj në kundërshtim me ligjin e Prokurimit Publik për shkak se nëse Operatori Ekonomik po të vepronte sipas propozimeve të dhëna nga Autoriteti kontraktues i njëjti do të dështonte në realizimin e këtij projekti, coftë në cilësin e punimeve, coftë në rrezikimin e nxënësve dhe objekteve tjera.

Këtë fakt gjykata e vërtetoi ngase Operatori Ekonomik kishte për detyrë që të përdorë materiale për nivelizimin e dyshemesë (estrih) i cili gjatë përdorimit të këtij materiali klasat duhet të jenë të zbratura dhe i njëjti kërkon kohë për tu tharë. Sipas vlerësimit të gjykatës Autoriteti Kontraktues nuk i kishte marr për bazë kërkesat e Operatorit Ekonomik, por i njëjti kishte kërkuar që punimet të zhvillohen pa ndërprerjen e mësimin duke dhënë propozime të pa bazuara dhe në kundërshtim me ligjet e Kosovës.

Për Gjykatën përveç provave tjera të administruara me lartë si prova me relevance në vendosjen e kësaj çështje kontestuese ishin provat si në vijim: 1. Njoftimi për shkëputjen e kontratës me numër protokollit 7391-2016-ë, i dt.09.11.2016, pastaj prova Deklarata me numër protokollit

648-2017, e dt.02.02.2017 e administruar me lart me të cilën vërtetohet se e paditura nuk ka krijuar kushte për realizimin e punimeve, me gjithë kërkesat e vazhdueshme të Operatorit Ekonomik që të zbatohen nenet e kontratës, konkretisht neni 6 me qëllim që Operatorit Ekonomik gjatë realizimit të punimeve rrezikonte së pari nxënësit në Shkollë, pastaj cilësinë e punimeve. Prandaj mos zbatimi i nenit 6 të Kontratës me numër të protokollit 5/400/16, e dt.16.08.2016 nga Autoriteti Kontraktues i ka shkaktuar dëme Operatorit Ekonomik i cili përkundër vullneti të tij për të gjetur një zgjidhje të pranueshme, nuk ka hasur në mirëkuptim me Autoritetin Kontraktues dhe zyrtaret tjerë të prokurimit. Ky fakt vërtetohet nga administrimi i provave të elaboruar me lartë, komunikimi i palëve ndërgjyqëse dhe provat shkresore nga të cilat kjo gjykatë gjeti se paditësve ishte shkëputur kontrata me arsyetimi se të Operatori Ekonomik nuk po i përmbahet kushteve të Kontratës, gjë që për Gjykatën një vlerësim i tillë është i pa mbështetur në ligj. Këtë vlerësim gjykata e mbështet për faktin se e paditura si Autoritet Kontraktues ka për detyrim të krijoj kushte për zbatimin e punimeve, siç parashihen në Dosjen e Tenderit që është standard për të gjitha procedurat e Prokurimit Publik si legjislacion sekondar ku fillimisht sipas dosjes se tenderit të cilën e pranojnë Operatorët Ekonomik si draft kontratë e me pas kontratën nga Autoriteti Kontraktues me të cilën Kontratë Obligohet Autoriteti Kontraktues që t'i mundësoj zbatimin e kontratës, konkretisht obligohet në dhënien e dokumentacionit, qasjen në vend punishte dhe programi për mënyrën e ekzekutimit të punëve. Në rastin konkret gjykata konstatoj se në dosjen standarde të tenderit parashihet se: *Autoriteti kontraktues, në kohën e duhur dhe në përputhje me ecurinë e punimeve, do ti jap qasje dhe akses Kontraktuesit në vend punishte, në përputhje me programin e zbatimit të detyrave të përcaktuara në këto Kushte të përgjithshme.* Pra dosja e tenderit në mënyrë shprehimore e përcakton qasjen në vend punishte si obligim i Autoritetit Kontraktues, gjë që në rastin konkret nuk i është ofruar paditësit sipas kushteve të përgjithshme të kontratës.

Po ashtu nga gjendja faktike e vërtetuar gjykata zbatoj nenet 6, 7 dhe 8 të Ligjit të Marrëdhënieve të Detyrimeve (tutje referuar si “LMD”), me të cilët thuhet se palët kontraktuese në marrëdhënie kontraktuese janë të obliguara t'i kryejnë obligimet e ndërsjellta dhe janë përgjegjëse lidhur me përmbushjen e tyre dhe se të kontratat dypalëshe pjesëmarrësit nisen nga parimi i vlerës së barabartë të dhënieve reciproke. Bazuar në këto dispozita edhe e paditura ka qenë e detyruar t'i përmbush obligimet kontraktuese në tërësi ashtu siç është paraparë me dokumentet kontraktuese.

Kjo gjykatë gjithashtu vlerëson se janë zbatuar dispozitat e ligjit material sepse sipas dispozitës së Nenit 106 të LMD-së me të cilin thuhet dhe citoj: *“në kontratat e dyanshme, kur njëra palë*

nuk e përmbushë detyrimin e saj, pala tjetër mundet, në qoftë se nuk është caktuar diç tjetër, të kërkojë përmbushjen e detyrimit ose, në kushtet të parashikuara në nenet e mëposhtëm, ta zgjidhë kontratën me deklaratë të thjeshtë, në qoftë se zgjidhja e kontratës nuk krijohet sipas vetë ligjit. Në çdo rast ka të drejtë në shpërblimin e dëmit” si dhe nenit 107.2 të LMD-së që thotë “kreditore mund ta mbajë kontratën në fuqi, në qoftë se pas skadimit të afatit, pa shtyrje e njofton debitorin se kërkon përmbushjen e kontratës”. Në rastin konkret, konform dispozitave ligjore të sipërcituara meqënëse paditesit e ka filluar punimet sipas kushte të kontratës, dhe meqënëse e drejta e përmbushjes së kontratës është e drejtë themelore, atëherë e paditura në cilësi të debitorit ka për detyrim që të kryejë pagesën për punët e kryera në shumën e përcaktuar si në kontratën “Renovimi i Shkollës në Gushtericë –Komuna e Graçanicës “.

Gjykata gjithashtu vlerësoi se është zbatuar edhe neni 136 i LMD-së ku thuhet dhe citoj: „*kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij*” duke qenë se nga provat e administruara më lart është vërtetuar që e paditura asnjëherë nuk ka krijuar kushte për zbatimin e kontratës sipas kushteve të parapara dhe në këtë mënyrë edhe i ka shkaktuar dëm paditësit në vlerë prej 8.700.00 Euro.

Lartësinë e kërkesë për pagesën e dëmit të shkaktuar nga e paditura, gjykata e mbështet në Raporti i vlerësimit i dt.09.01.2019, ku eksperti Lulëzim Dema kishte vlerësuar se kompensimi i dëmit të bëhet vetëm për pjesën e fuqisë punëtore e cila përfshin parapërgatitjen dhe demolimin, pa i përlloritur pozicionet e zdrukthëtarisë dhe nivelimit të cilat pozicione do të bëheshin nga sub kontraktorit.

Lidhur me vendosjen e lartësisë së kamatës të përcaktuar 8 %, gjykata vendosi në pajtim me dispozitën e nenit 382 të LMD-së duke e llogaritur nga data e parashtrimit të padisë datë 20.12.2016 e deri në pagesën definitive.

Gjykata e vlerësoi edhe pretendimin e të paditurës se paditësi nuk e ka përmbushësh kontratën duke u vonuar në kryerjen e punëve, por të njëjtin e konsideroi si jo-relevant në këtë çështje për arsye se, nga provat e administruara u vërtetua qartë se mos zbatimi i punimeve ishin shkaktuar me veprimet e të paditurës për shkak të ndërrimit të projektit fillestar dhe vonesave tjera objektive që kanë qenë jashtë kontrollit të paditësit, siç janë qasja në vend punishte, lirimi i objektit nga nxënësit dhe largimi i inventarit.

Vendimin për caktimin e shpenzimeve procedurale si në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit, gjykata e ka vendosur konform nenit 452 par. 1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, ndërkaq lartësinë e kërkesës e caktoi sipas tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës – nr. tarifor 6 dhe 7, për këto shpenzime: për përpilimin e padisë 156.00 euro, për taksën gjyqësore në shumën prej 61.00 Euro, për angazhimin e ekspertit financiar në shumën prej 500.00 Euro, për 5 seanca të mbajtura (për seancë 5x 202.80 Euro) 1,014.00 Euro, e që në total rezultojnë 1,670.00 Euro.

Nga sa u tha me larte, konform nenit 8 dhe nenit 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi – pika I, ndërsa vendimin mbi shpenzimet e procedurës e bazoi në nenin 452 par. 1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore.

GJYKATA KOMERCIALE

Dhomat e Shkallës I - Departamenti për Çështje Ekonomike

KE.nr.154/22, datë 08.05.2024

Gj y q t a r i,
Alajdin Tërshnjaku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të këtij Aktgjykimit, Gjykatës Komerciale – Dhoma e Shkallës së dytë, përmes kësaj Gjykate.